



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim

Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit

Vendosi: Gjykatësi i Vetëm

Gjykatës Kristofer Gosnell

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 dhjetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Gjashtë mbi Rishikimin e
Paraburgimit të Isni Kilajt**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Administratores
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Njesisë së Paraburgimit
Shefit të Njesisë së Paraburgimit

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit:
Aleksandër Admiral

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIMET.....	4
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
IV.	DISKUTIM	7
A.	Kërkesa për zgjatje të afatit.....	7
B.	Dyshimi i bazuar	7
C.	Prania e rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b).....	8
1.	Rreziku i arratisjes.....	8
2.	Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së.....	12
3.	Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera	15
4.	Përfundim	15
D.	Kushtet e mundshme të lirit	16
E.	Proporcionaliteti i paraburgimit	17
F.	Kushtet e lirit	25
V.	KLASIFIKIMI.....	28
VI.	VENDIM.....	29

GJYKATËSI I VETËM, në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 9(5)(a) dhe (6), 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës,¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 nëntor 2023, Isni Kilaj ("z. Kilaj") u arrestua në bazë të urdhërarrestimit të lëshuar nga Prokurorja e Specializuar sipas rregullës 52(1).² Më 3 nëntor 2023, ai u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS"),³ në bazë të urdhrit për transferim të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.⁴

2. Më 3 maj 2024, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi lirimin e përkohshëm të z. Kilaj, i cili u zbatua më 15 maj 2024.⁵ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") e apeloj këtë vendim bazuar në pretendimin se Gjykatësi i Vetëm nuk i kishte dhënë ZPS-së mundësinë të shprehej në lidhje me kushtet e lirimit, por jo se Gjykatësi i Vetëm

¹ Në vijim, të gjitha referencat ku përmendet "neni" dhe "rregulla" duhet të kuptohen si referenca për nene dhe rregulla përkatësisht të Ligjit dhe Rregullores, përveç nëse saktësohet ndryshe.

² KSC-BC-2023-12, INV-F00039, Prokurorja e Specializuar, [Urgent Rule 52\(1\) Notification of Arrest of Isni Kilaj](#) (Njoftim Urgjent sipas Rregullës 52(1) për Arrestimin e Isni Kilajt), 2 nëntor 2023, publik.

³ KSC-BC-2023-12, INV-F00043, Administratorja, [Notification of Reception of Isni Kilaj in the Detention Facilities of the Specialist Chambers](#) (Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara), 3 nëntor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; INV-F00045, Administratorja, *Raport për Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit*, 3 nëntor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor dhe versionet konfidenciale dhe *ex parte* të shtojcave, përkatësisht, INV-F00045/RED, INV-F00045/RED/A01/CONF/RED dhe INV-F00045/RED/A02/CONF/RED, u dorëzuan më 8 nëntor 2023.

⁴ KSC-BC-2023-12, INV-F00041/COR, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Urdhrin për Transferim në bazë të Arrestimit të kryer nga Prokurorja e Specializuar*, 3 nëntor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; version i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 5 nëntor 2023, [INV-F00041/COR/RED](#).

⁵ KSC-BC-2023-12, INV/F00129/COR, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt ("Vendimi mbi Lirimin e Kilajt")*, 3 maj 2024 (versioni i korrigjuar u lëshua më 15 maj 2024), konfidencial; versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [INV/F00129/COR/RED](#); INV/F00135/COR, Administratorja, *Version i Korrigjuar i Njoftimit për Transferimin e Isni Kilajt në Kosovë (F00670)*, 15 maj 2024 (versioni i korrigjuar u dorëzua më 10 nëntor 2025), publik.

kishte gabuar në vlerësimin e vet se periudha e paraburgimit ishte bërë e paarsyeshme.⁶

3. Më 5 dhjetor 2024, z. Kilaj u riarrestua në Kosovë, në bazë të fletarrestimit të DHS-së të lëshuar pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij dhe katër të akuzuarve të tjerë më 29 nëntor 2024.⁷

4. Më 9 dhjetor 2024, z. Kilaj pati paraqitjen e tij të parë në seancë, ku u urdhërua vazhdimi i paraburgimit të tij.⁸ Ai aktualisht vazhdon të jetë në paraburgim, pas pesë rishikimeve të paraburgimit të tij të bëra çdo dy muaj, sikurse kërkohet nga neni 41(10).⁹

⁶ KSC-BC-2023-12, INV-F00270, Prokurorja e Specializuar, *Apel i Prokurorisë kundër Vendimit F00658 dhe Kërkesë për Efekt Pezullues*, 6 maj 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 31 korrik 2024, [INV-F00270/RED](#).

⁷ KSC-BC-2023-12, F00043, Administratorja, *Notification of Arrest of Isni Kilaj Pursuant to Rule 55(4)* (Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)), 5 dhjetor 2024, publik; F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi mbi Arrestimin"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#); F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 29 nëntor 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

⁸ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, 9 dhjetor 2024 ("Vendimi mbi Paraburgimin"), publik, f. 85-125, veçanërisht f. 120, rreshti 20 deri në f. 124, rreshti 23; IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Decision on Continued Detention* (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt"), 28 janar 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00162, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision on Review of Detention of Isni Kilaj* (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt) ("Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit"), 7 shkurt 2025, publik; F00248, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Second Decision on Review of Detention of Isni Kilaj* (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit"), 7 prill 2025, publik; F00324, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Third Decision on Review of Detention of Isni Kilaj* (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt) ("Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit"), 5 qershor 2025, publik; F00403, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Fourth Decision on Review of Detention of Isni Kilaj* (Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt) ("Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit"), 5 gusht 2025, publik; F00478, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Fifth Decision on Review of Detention of Isni Kilaj* (Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt) ("Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit"), 3 tetor 2025, publik. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Third Decision on Review of Detention* (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt"), 1 shtator 2025, publik.

5. Më 12 nëntor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e plotë të çështjes Gjykatësit të Vetëm për gjykimin e çështjes.¹⁰
6. Më 18 nëntor 2025, ZPS-ja dorëzoi parashtrime në lidhje me rishikimin e gjashtë të rregullt të paraburgimit të z. Kilaj,¹¹ ndaj të cilave Mbrojtja e z. Kilaj ("Mbrojtja e Kilajt") u përgjigj më 25 nëntor 2025.¹²
7. Më 26 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm ftoi ZPS-në dhe Mbrojtjen e Kilajt të dorëzonin parashtrime të mëtejshme në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Kilaj.¹³
8. Më 1 dhjetor 2025, sipas udhëzimit të Gjykatësit të Vetëm, ZPS-ja dhe Mbrojtja e Kilajt dorëzuan parashtrime të mëtejshme në lidhje me disa aspekte konkrete.¹⁴

II. PARASHTRIMET

9. ZPS-ja kërkon vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj, për arsye se nuk ka pasur "ndryshime me pasoja ose zhvillime domethënëse që rrëzojnë" Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit.¹⁵ Siç shtjellohet më hollësisht më poshtë, ZPS-ja rithekson se secili prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b),¹⁶ vazhdon të ekzistojë, dhe ato nuk mund të "zvogëlohen sa duhet" me asnjë kusht të mundshëm

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00544, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Transmitting the Case File to Single Trial Judge](#) (Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Gjykatësit të Vetëm), 12 nëntor 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00554, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt* ("Parashtrimet e ZPS-së"), 18 nëntor 2025, publike.

¹² KSC-BC-2023-12, F00574, Mbrojtja e Kilajt, *Përgjigje e Kilajt ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (F00554)* ("Përgjigja e Kilajt"), 25 nëntor 2025, publike.

¹³ KSC-BC-2023-12, F00577, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Dorëzimin e Parashtrimeve të Mëtejshme në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 26 nëntor 2025, konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁴ KSC-BC-2023-12, F00590, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Mëtejshme të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt (F00577)* ("Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së"), 1 dhjetor 2025, konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*; F00591, Mbrojtja e Kilajt, *Parashtrime të Mëtejshme të Kilajt në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Parashtrimet Plotësuese të Kilajt"), 1 dhjetor 2025, konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i korrigjuar i Shtojcës 1 u dorëzua më 2 dhjetor 2025, F00594 dhe F00594/A01.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2-4, 10-11.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 4-7.

lirimi, “përfshirë garancinë financiare, detyrimin për paraqitje dhe kufizimet për komunikimet dhe lëvizjen”.¹⁷ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se “koha e shkurtër që ka kaluar” që nga rishikimi i fundit i paraburgimit nuk dëmton proporcionalitetin e paraburgimit të z. Kilaj, duke pasur parasysh dënimin e mundshëm me burgim të gjatë dhe ecurinë e çështjes drejt gjykimit.¹⁸

10. Mbrojtja e Kilajt kërkon lirimin me kusht të z. Kilaj, mbi bazën e “ndryshimeve me pasoja dhe zhvillimeve domethënëse” që kanë ndodhur që nga Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit.¹⁹ Sipas Mbrojtjes së Kilajt: (i) rreziku që z. Kilaj të pengojë procesin e DHS-së, është zvogëluar ndjeshëm;²⁰ (ii) nuk është e arsyeshme ose proporcionale që z. Kilaj të vazhdojë të mbetet në paraburgim edhe për dy muaj të tjerë, në pritje të fillimit të gjykimit,²¹ duke marrë parasysh se ai tashmë ka kaluar 18 muaj e gjysmë në paraburgim;²² dhe (iii) nëse do të miratohej lirimi me kusht i z. Kilaj, ai nuk do të rrezikonte ribashkimin me familjen e tij duke u arratisur ose duke kryer përsëri vepra penale.²³ Së fundi, Mbrojtja e Kilajt parashtron se çdo rrezik që konstatohet se ekziston, mund të mbahet nën kontroll me vendosjen e kushteve të rrepta për lirimin e tij, përfshirë garancinë financiare prej 40.000 eurosh [REDAKTUAR].²⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Standardet që zbatohen për vazhdimin e paraburgimit të një personi nga Dhomat e Specializuara përcaktohen në nenin 41(6), (10) dhe (12) dhe rregullat 56-57. Këto dispozita janë interpretuar gjerësisht në jurisprudencën e Dhomave të

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9, me referenca të mëtejshme.

¹⁹ Përgjigja e Kilajt, para. 2, 30.

²⁰ Përgjigja e Kilajt, para. 3, 11-17.

²¹ Përgjigja e Kilajt, para. 4, 18.

²² Përgjigja e Kilajt, para. 5, 19-25.

²³ Përgjigja e Kilajt, para. 26-27.

²⁴ Përgjigja e Kilajt, para. 28; Parashtrimet Plotësuese të Kilajt, para. 10.

Specializuara, veçanërisht pasi kërkohet që ato të zbatohen dhe interpretohen në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.²⁵ Gjykatësi i Vetëm do të zbatojë të njëjtat standarde në këtë vendim.

12. Gjykatësi i Vetëm vë në dukje se çdo rishikim i paraburgimit që kryhet çdo dy muaj, është shqyrtim *de novo*.²⁶ Sipas Panelit të Gjykatës së Apelit, “paneli kompetent nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë për të cilët është marrë tashmë vendim në vendimin e parë mbi paraburgimin, por duhet të shqyrtojë arsyet dhe rrethanat në fjalë dhe të përcaktojë nëse ende ekzistojnë. Thelbësore është që paneli kompetent të bindet se në kohën e marrjes së vendimit mbi rishikimin e paraburgimit, ende ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit”.²⁷ Gjithashtu, “ndonëse rishikimi automatik [...] nuk kufizohet rreptësisht me ndryshimin e rrethanave të çështjes, gjithsesi një ndryshim i tillë mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh nëse ngrihet para Panelit apo *proprio motu*”.²⁸ Gjykatësi i Vetëm e kupton që, megjithëse prej tij nuk “kërkohet” të rishqyrtojë konstatimet e bëra në vendime të mëhershme mbi rishikimin e

²⁵ Shih, për shembull, [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit), para. 12-15; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit), para. 14-15 (kriteret e përgjithshme), 16 (dyshimi i bazuar), 21-24 (domosdoshmëria e paraburgimit), 35 (lirimi me kusht), 40 (proporcionaliteti).

²⁶ KSC-BC-2020-06, IA006/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit), 1 tetor 2021, publik, para. 14-17; F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Application for Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm), 22 janar 2021, publik, para. 26; F03484, Trupi Gjykues II, [Decision on Periodic Review of Detention of Jakup Krasniqi](#) (Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit), 18 shtator 2025, publik, para. 49 (“Trupi Gjykues vëren se paraburgimi bëhet sipas kushteve të rrepta të përcaktuara në nenin 41 dhe Trupi Gjykues shqyrton parashtrimet e palëve *de novo* në kuadër të rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj në përputhje me nenin 41(10)”).

²⁷ KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Nasim Haradinaj's Appeal Against Decision Reviewing Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 9 shkurt 2021, publik, para. 55.

²⁸ [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 31.

paraburgimit, gjithsesi ai ka detyrimin të sigurojë që është “bindur” se “ende ekzistojnë arsytet për vazhdimin e paraburgimit”, përfshirë, ndër të tjera, marrjen parasysh të çdo ndryshimi të rrethanave që mund të ketë ndodhur që nga vendimi i fundit mbi rishikimin e paraburgimit.

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA PËR ZGJATJE TË AFATIT

13. Paraprakisht, Gjykatësi i Vetëm vëren se, para përfundimit të afatit për dorëzimin e Përgjigjes së Kilajt, Mbrojtja e Kilajt kërkoi një zgjatje me tetë orë të afatit, për arsye se kishte pasur trysni të papritur pune në lidhje me konferencën e përgatitore për gjykimin që do të mbahej më 28 nëntor 2025.²⁹ Mbrojtja e Kilajt parashtroi se ishte konsultuar me ZPS-në, e cila nuk e kishte kundërshtuar kërkesën dhe se kjo nuk do të shkaktonte asnjë dëm.³⁰

14. Gjykatësi i Vetëm konstaton se kërkesa për zgjatje të afatit u paraqit në kohë, sikurse kërkohet në bazë të rregullës 76, dhe se ajo mbështetet në shkaqe të vlefshme, për arsytet e paraqitura nga Mbrojtja e Kilajt, ndër të cilat mungesa e kundërshtimit prej ZPS-së. Rrjedhimisht, kërkesa për zgjatjen e afatit miratohet në përputhje me rregullën 9(5)(a) dhe (6).

B. DYSHIMI I BAZUAR

15. Sipas nenit 41(6)(a), parakusht për paraburgimin është ekzistenca e “dyshimit të bazuar se [i paraburgosuri] ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara”. Ky është një standard më i ulët se ai që kërkohet për konfirmimin e aktakuzës sipas nenit 39(2). Në bazë të

²⁹ Përgjigja e Kilajt, para. 6-7. *Shih* KSC-BC-2023-12, CRSPD166, 25 nëntor 2025, konfidencial.

³⁰ Përgjigja e Kilajt, para. 6-7.

konstatimeve në Vendimin e Konfirmimit,³¹ dhe në mungesë të argumenteve apo zhvillimeve të reja, përmbushet kriteri i “dyshimit të bazuar” sipas nenit 41(6)(a).

C. PRANIA E RREZIQEVE TË PËRCAKTUARA NË NENIN 41(6)(B)

1. Rreziku i arratisjes

16. ZPS-ja përmend tre faktorë që tregojnë rrezikun se, po të lirohej përkohësisht, z. Kilaj do të arratiset: (i) peshën e veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat, përfshirë dijeninë e tij për provat që mbështesin akuzat dhe dënimin e konsiderueshëm të mundshëm në rast të shpalljes fajtor; (ii) mjetet e tij për t’u arratisur dhe mundësinë për t’iu shmangur drejtësisë; dhe (iii) aftësinë e tij për të mobilizuar mbështetje në Kosovë për t’u arratisur.³²

17. Si dhe në parashtrimet e mëhershme, Mbrojtja e Kilajt argumenton se edhe në qoftë se dënohet për të gjitha akuzat më të cilat përballet, “koha që z. Kilaj ka kaluar gjithsej në paraburgim, shtuar kohën e kaluar në lirim të përkohshëm, tejkalon çdo dënim të mundshëm me burgim”.³³ Mbrojtja e Kilajt argumenton se është e paarsyeshme të nxirret përfundimi se ekziston rreziku i arratisjes, pasi dëshira e z. Kilaj për t’u kthyer pranë familjes së tij nënkupton se ai është “i vendosur të mos bëjë asgjë që mund të rrezikojë ribashkimin e tyre”.³⁴ Mbrojtja e Kilajt gjithashtu parashtron se çdo rrezik mund të “mbahet nën kontroll” me vendosjen e po atyre kushteve që u urdhëruan kur z. Kilaj u lirua përkohësisht në maj 2024, dhe se “garancia financiare e propozuar aktualisht prej 40.000 eurosh, tregon se ai nuk ka asnjë motiv për t’u arratisur”.³⁵

³¹ *Shih Confirmation Decision* (Vendimi i Konfirmimit), para. 43, 211, 260, 287-288, 299, 313(d).

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

³³ Përgjigja e Kilajt, para. 24.

³⁴ Përgjigja e Kilajt, para. 26-27.

³⁵ Përgjigja e Kilajt, para. 28.

18. Paneli i Gjykatës së Apelit ka përcaktuar qartë standardin më të ulët të rrezikut për konstatimin e ekzistencës së një apo më shumë rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b):

Paneli rikujton konstatimin e vet të mëhershëm se, për përcaktimin e domosdoshmërisë së paraburgimit, pyetja që ngrihet ka të bëjë me mundësinë, jo me pashmangshmërinë, e një ngjarjeje në të ardhmen. [...] Me këtë konstatim, Paneli pranoi se mund të zbatohet një standard më i ulët se pashmangshmëria. Që “pashmangshmëria” nuk mund të jetë kriter rrjedh nga lloji i vlerësimit që bëhet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, pasi ajo përfshin një parashikim në lidhje me veprime të ardhshme, dhe ajo çka mund të ndodhë në të ardhmen asnjëherë nuk mund të parashikohet me siguri. Kjo megjithatë nuk do të thotë se çdo mundësi e materializimit të një rreziku, është e mjaftueshme për të përligjur mbajtjen në paraburgim. Në këtë aspekt, Paneli konstaton se argumenti i Thaçit është i themeltë, kur i referohet çështjes Katanga dhe Ngudjolo, se paraburgimi nuk mund të përligjet nga asnjë lloj mundësie e ndodhjes së një ngjarjeje në të ardhmen, qoftë ajo dhe e papërfillshme. [...] Paneli gjithashtu mban parasysh konstatimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“[...]”) se çdo heqje lirie duhet të bëhet në përputhje me rregullat materiale dhe procedurale të përcaktuara me ligj dhe në përputhje me qëllimin kryesor të mbrojtjes së individit nga arbitrariteti. Si pjesë e mbrojtjes nga arbitrariteti, Paneli thekson rëndësinë e dhënies së arsytimit specifik dhe arsyeve konkrete, në të cilat duhet të mbështetet Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimet për autorizimin e paraburgimit. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se standardi që duhet të zbatohet është, nga njëra anë, më i ulët se pashmangshmëria, por, nga ana tjetër, më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.³⁶

19. Gjykatësi i Vetëm vëren se në Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se standardi i nevojshëm për përcaktimin e rrezikut të arratisjes, për z. Kilaj ishte përmbushur për shkak të: (i) peshës së veprave penale për të cilat ai akuzohet; (ii) dijenisë së tij për provat e ZPS-së që mbështesin ato akuza; (iii) mundësisë së një dënimi të konsiderueshëm si rezultat i shpalljes fajtor për ato akuza; (iv) mjeteve të tij për

³⁶ KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaci's Appeal Against Decision on Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm), 30 prill 2021, publik, para. 21-22.

t'u arratisur dhe për t'iu shmangur drejtësisë; dhe (v) sepse ai "mund të ketë aftësinë për të mobilizuar mbështetje për qëllimin e arratisjes, duke pasur parasysh profilin e njohur publik të tij në Kosovë".³⁷ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk i dha peshë pagesës së propozuar të garancisë financiare me arsyetimin se "Mbrojtja e Kilajt nuk shpjegon se si një propozim i tillë zvogëlon ose eliminon rrezikun e arratisjes dhe, rrjedhimisht, nuk do ta marrë parasysh atë".³⁸

20. Gjykatësi i Vetëm konstaton se që nga vendimi i fundit i rishikimit të paraburgimit, rrethanat kanë ndryshuar në të paktën dy aspekte: (i) kohëzgjatja e mundshme e çdo afati të ardhshëm burgimi, si rezultat i dënimit që mund t'i jepet z. Kilaj (dhe, rrjedhimisht, motivi për t'u arratisur) është zvogëluar me dy muaj të tjerë paraburgimi (çka zvogëlon kohëzgjatjen e çdo dënimi të ardhshëm që mund t'i jepet);³⁹ dhe (ii) Mbrojtja e Kilajt ka dhënë detaje shtesë në lidhje me burimin e garancisë financiare që do të ofrohet, e cila, në pamje të parë, duket se është [REDAKTUAR].⁴⁰ Meqenëse duket se [REDAKTUAR] janë burimi i garancisë financiare që nuk do të kthehej në rast të mospërbushjes së kushteve, kjo shërben si tregues shtesë se z. Kilaj nuk do të arratiset kaq lehtë, [REDAKTUAR]. Gjykatësi i Vetëm konstaton se të dy këta faktorë zvogëlojnë nivelin e rrezikut të arratisjes.

21. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu i kushton rëndësi të konsiderueshme periudhës së mëparshme të lirimit të përkohshëm të z. Kilaj në Kosovë midis 15 majit dhe 5 dhjetorit 2024, që gjithashtu u kushtëzua me pagesën e një garancie financiare që nuk do të kthehej në rast mosparaqitjeje në DHS.⁴¹ Siç është

³⁷ [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 19.

³⁸ [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 20.

³⁹ *Shih* Rregullën 163(6) ("Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit me burgim, trupi gjykues zbrit kohën që i akuzuari është mbajtur në paraburgim, në rast se është mbajtur, në përputhje me Kapitullin 4").

⁴⁰ Parashtrimet Plotësuese të Kilajt, para. 1-17; Shtojcat 1-4 të Parashtrimeve Plotësuese të Kilajt.

⁴¹ [First Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 6, 12.

shprehur Paneli i Gjykatës së Apelit, akuzat me të cilat përballet aktualisht z. Kilaj “çojnë në një dënim të mundshëm të ngjashëm nga një deri në pesë vjet, si dënimi për të cilin Kilaj ishte në dijeni në kohën e lirimit të tij me kusht”.⁴² Rreziku i pranuar i arratisjes në kohën e lirimit të mëparshëm të përkohshëm të z. Kilaj, i cili në atë kohë u cilësua si “serioz”,⁴³ nuk u materializua. Përkundrazi, nuk ka tregues (as argumente të ZPS-së që pretendojnë) se z. Kilaj shkeli në ndonjë mënyrë ndonjë prej kushteve të lirimit. Duke pasur parasysh se në atë kohë ai e dinte se akuzat e mundshme ndaj tij ishin po aq të rënda sa ato me të cilat përballet tani,⁴⁴ kësaj periudhe të mëhershme të lirimit të tij duhet t’i jepet peshë e konsiderueshme në vlerësimin e rrezikut aktual të arratisjes së z. Kilaj.⁴⁵ Në rrethana të ngjashme, Dhoma Gjyqësore e Gjykatës Penale Ndërkombëtare ka konstatuar se “këtij faktori duhet t’i jepet peshë e konsiderueshme, sepse sjellja në fazën e procedurës paraprake e katër të akuzuarve gjatë kohës që u liruan, është tregues i drejtpërdrejtë se çfarë rreziqesh mund të shkaktohen nga

⁴² [First Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 41.

⁴³ KSC-BC-2023-12, INV-F00273, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt* (“Vendimi mbi Apelin e ZPS-së”), 13 maj 2024, konfidencial, para. 22; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 maj 2024, [INV-F00273/RED](#).

⁴⁴ Dijenja e z. Kilaj se akuzat çonin në një dënim “të mundshëm të ngjashëm si dënimi” që ai mund të marrë aktualisht, u pranua shprehimisht nga Paneli i Gjykatës së Apelit. *Shih* [First Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 41 (“akuzat e konfirmuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake faktikisht çojnë në një dënim të mundshëm të ngjashëm nga një deri në pesë vjet, si dënimi për të cilin Kilaj ishte në dijeni në kohën e lirimit të tij me kusht”).

⁴⁵ *Shih* [First Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 33 (“sjellja e një të dyshuari ose të akuzuari në pritje të gjykit dhe përmbyllja e kushteve të lirimit/urdrave të gjykatës janë faktorë relevantë për rishikimin e paraburgimit ose shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e fletarrestimeve ose për lirim, ndonëse pesha që i jepet këtij faktori duhet të vlerësohet rast pas rasti”. Ndonëse në Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit u shqyrtua nëse kushtet e mundshme të lirimit mund të zvogëlonin rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b), në të nuk u trajtua shprehimisht se sa relevante ishte periudha e mëhershme e lirimit me kusht për përcaktimin e nivelit të vetë rrezikut të arratisjes. Edhe në atë Vendim, niveli në të cilin kushtet mund të zvogëlojnë rrezikun, u trajtua shprehimisht vetëm në lidhje me rrezikun e pengimit dhe rrezikun e përsëritjes së veprave penale, jo në lidhje me rrezikun e arratisjes. *Shih* [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 19-21, 30-33.

vazhdimi i lënies së tyre në liri”.⁴⁶ Në fakt, mundësitë që ai të përpiqet të arratiset aktualisht janë zvogëluar ndjeshëm krahasuar me majin e vitit 2024, sepse ai tani ka kaluar edhe një vit në paraburgim, gjë që zvogëlon me po aq kohëzgjatjen e dënimit të mundshëm.

22. Duke marrë parasysh sa më lart, dhe pavarësisht nga mungesa e ndonjë ndryshimi të konsiderueshëm në lidhje me faktorët e tjerë të evidentuar në Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit (ndër ta pesha e veprave penale, mjetet që supozohet se ai ka për t’u arratisur dhe për të mobilizuar mbështetje), Gjykatësi i Vetëm konstaton se z. Kilaj nuk paraqet rrezik arratisjeje sipas nenit 41(6)(b)(i), në qoftë se lirimi i tij bëhet me të njëjtat kushte ose me kushte të ngjashme lirimi me ato të urdhëruara në maj 2024.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

23. ZPS-ja parashtron se faktorët e mëposhtëm tregojnë rrezikun që, në qoftë se lirohet përkohësisht, z. Kilaj do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së: (i) gatishmëria e demonstruar e tij për të shkelur urdhrat e gjykatës dhe për të ndërhyrë në procese në të cilat nuk është palë, duke keqpërdorur me dashje informacionin në lidhje me dëshmitarët, në shpërfillje të plotë të rregullave të konfidencialitetit; (ii) njohuritë për akuzat ndaj tij dhe dijenia për provat në mbështetje të tyre; dhe (iii) qasja e tij në informacion të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët.⁴⁷ Si faktorë relevantë kontekstualë, ZPS-ja përmend gjithashtu atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave në Kosovë dhe profilin e njohur publik të z. Kilaj.⁴⁸

24. Mbrotjtja e Kilajt parashtron se mundësitë që z. Kilaj të ndërhyjë në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* (gjykimi “Thaçi dhe të tjerët”

⁴⁶ International Criminal Court, *The Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-1151, Trial Chamber VII, [Decision Regarding Interim Release](#) (“Bemba et al. Decision on Interim Release”), 17 August 2015, para. 20.

⁴⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

ose “Çështja 06”) janë zvogëluar ndjeshëm, pasi faza e paraqitjes së provave në atë çështje po i afrohet me shpejtësi përfundimit.⁴⁹ Në veçanti, Mbrojtja e Kilajt argumenton se: (i) në Çështjen 06 nuk do të thirren dëshmitarë shtesë të Mbrojtjes;⁵⁰ (ii) Trupi Gjykses në Çështjen 06 nuk ka ndërmend të paraqesë prova;⁵¹ (iii) mocionet për paraqitje kundërprovash do të miratohen vetëm si përjashtim;⁵² dhe (iv) ZPS-ja nuk ka ngritur pretendimin për rrezikun që z. Kilaj të ndërhyjë ndaj ndonjë dëshmitari të mundshëm të përfshirë në mocionet për paraqitje kundërprovash.⁵³ Gjithashtu, Mbrojtja e Kilajt parashtrohet se, në çështjen aktuale, rreziku i ndërhyrjes të dëshmitarët, duke pasur parasysh profilet e tyre,⁵⁴ është i ulët, dhe thekson se nuk ka prova për ndonjë veprim të z. Kilaj mbi bazën e informacionit konfidencial që ai disponon në lidhje me dëshmitarët.⁵⁵ Së fundi, Mbrojtja e Kilajt argumenton se shuma prej 40.000 eurosh e propozuar si garanci financiare, tregon se ai nuk ka motiv për të penguar procesin e DHS-së.⁵⁶

25. Gjykatësi i Vetëm konstaton se faktorët e përcaktuar në Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit dhe të evidentuar prej ZPS-së, vazhdojnë të jenë të vlefshëm dhe, për arsyt e renditura në atë vendim, tregojnë njëfarë rreziku pengimi, megjithëse Mbrojtja e Kilajt argumenton se z. Kilaj nuk do ta bënte këtë po të lirohej përkohësisht.⁵⁷

26. Megjithatë, ky rrezik është zvogëluar për shkak të dy faktorëve. Së pari, ndër dëshmitarët në të cilët do të mbështeten provat dhe argumentet e ZPS-së në këtë çështje, nuk përfshihen ata të cilët z. Kilaj ka më shumë të ngjarë të

⁴⁹ Përgjigja e Kilajt, para. 3, 14.

⁵⁰ Përgjigja e Kilajt, para. 11.

⁵¹ Përgjigja e Kilajt, para. 12.

⁵² Përgjigja e Kilajt, para. 13.

⁵³ Përgjigja e Kilajt, para. 13.

⁵⁴ Përgjigja e Kilajt, para. 15.

⁵⁵ Përgjigja e Kilajt, para. 16-17.

⁵⁶ Përgjigja e Kilajt, para. 28.

⁵⁷ *Shih* [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 22-23, 25.

dojë të ndikojë, konkretisht ata që pretendohet se janë shënjestra të mundshme të ndërhyrjes nga z. Kilaj sikurse përcaktohet në Vendimin e Konfirmimit.⁵⁸ Së dyti, paraqitja e provave në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* tani pothuajse ka përfunduar (çka gjithashtu është ndryshim rrethanash që nga Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit).⁵⁹ Gjykatësi i Vetëm konstaton se këto rrethana nuk eliminojnë mundësinë e hakmarrjes ndaj dëshmitarëve që tashmë kanë dëshmuar në Çështjen 06, ose atë të ushtrimit të ndikimit të palejueshëm ndaj tyre që ata të tërheqin dëshmitë,⁶⁰ veçanërisht duke pasur parasysh atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë ndaj dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të DHS-së.⁶¹ Sidoqoftë, mundësia që ky rrezik të manifestohet është ndjeshëm më e ulët sesa në lidhje me dëshmitarët që ende nuk kanë dëshmuar.

⁵⁸ Shih KSC-BC-2023-12, F00459/A03, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Paraprake, Listave të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale*, 19 shtator 2025, konfidenciale. Lista e dëshmitarëve u ridorëzua më 26 shtator 2025 me numër protokollimi F00467/A03, pas dorëzimit të versionit të korrigjuar të dosjes paraprake.

⁵⁹ Shih KSC-BC-2020-06, F03597, Trupi Gjykses II, [Order Pursuant to Rules 134\(b\), \(d\) and 159\(6\) and Related Matters](#) (Urdhër sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) dhe Çështje të lidhura me Të), 21 nëntor 2025, publik, para. 39.

⁶⁰ Shih [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 23; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 31. Shih [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 74, dhe referencat e cituara në të. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA033/F00006, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Rexhep Selimi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 54; IA035/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 34.

⁶¹ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 25; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 32; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 25; [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 63. Shih gjithashtu [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 83.

27. Rrjedhimisht, në rast të lirimit të përkohshëm të z. Kilaj, ndonëse rreziku i pengimit të procesit sipas nënparagrafit (ii) të nenit 41(6)(b) vazhdon të ekzistojë, ai vlerësohet si rrezik i moderuar.⁶²

3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

28. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësi i Vetëm rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk rezulton automatikisht në rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera, në këtë çështje ekzistenca e të parit rezulton në të dytin. Arsyet për të besuar se ekziston rreziku real i pengimit të procesit po kështu mbështesin konstatimin për ekzistencën e një rreziku real, ndonëse të moderuar, që në këtë kuadër të kryhen vepra penale të tjera të pretenduara, përfshirë ndaj dëshmitarëve të Mbrojtjes që mund të japin dëshmi në çështjen aktuale.⁶³

29. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Vetëm arrin në përfundimin se, po të lirohet përkohësisht, z. Kilaj do të kryejë vepra penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii).

4. Përfundim

30. Gjykatësi i Vetëm është bindur dhe konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku real, edhe pse i moderuar, që z. Kilaj të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë vepra penale të tjera, përkatësisht sipas nënparagrafëve (ii) dhe (iii) të nenit 41(6)(b). Gjykatësi i Vetëm më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm me ndonjë prej kushteve për lirin e z. Kilaj.

⁶² [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 25; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 32; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 29.

⁶³ *Shih për ngjashmëri* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 27; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 34; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 32; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 27; Vendimi mbi Paraburgimit, f. 123, rreshtat 3-7; [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 65.

D. KUSHTET E MUNDSHME TË LIRIMIT

31. Një i akuzuar mund të paraburgoset “vetëm në qoftë se masat më të buta do të ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rreziqet e arratisjes, pengimit të procesit ose kryerjes së krimeve të tjera”.⁶⁴ Ky standard pasqyron animin në favor të lirimit të të akuzuarit para gjykimit, që në vetvete është pasqyrim i parimit themelor të prezumimit të pafajësisë.⁶⁵

32. Gjykatësi i Vetëm tashmë ka trajtuar ndikimin e kushteve të mundshme të lirimit në vlerësimin e rrezikut të arratisjes dhe nuk ka nevojë ta përsërisë atë vlerësim në këtë pikë.

33. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit ose kryerjes së veprave penale të tjera, Gjykatësi i Vetëm nuk mund të konstatojë se kushtet e lirimit do të zvogëlonin ndjeshëm këto rreziqe. Gjykatësi i Vetëm mban parasysh se z. Kilaj ka ofruar që garancia financiare që do të paguhet në emër të tij, të mos i kthehet në rast të shkeljes së cilitdo prej kushteve të lirimit, përfshirë kushtet që mund të lidhen me kontaktimin e dëshmitarëve.⁶⁶ Ndonëse kjo ofertë është marrë në

⁶⁴ [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 32. *Shih* KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Adopted by Plenary on 17 March 2017 to the Specialist Chamber of the Constitutional Court Pursuant to Article 19\(5\) of Law No. 05/L-053 on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office](#) (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 Mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar), 26 prill 2017, publik, para. 114; European Court of Human Rights, [Buzadji v. the Republic of Moldova](#), no. 23755/07, Judgment, 5 July 2016, para. 87; [Idalov v. Russia](#), no. 5826/03, Judgment, 22 May 2012, para. 140.

⁶⁵ KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Rexhep Selimi's Appeal Against Decision on Interim Release](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm) (“Vendimi mbi Apelin e Selimit”), 30 prill 2021, publik, para. 85-86, ku thuhet se “gjatë vlerësimit të kushteve të propozuara, kërkohet që [paneli përkatës], të shqyrtojë dhe vlerësojë, *proprio motu*, të gjitha kushtet e arsyeshme që mund t’i vihen një të akuzuari dhe jo vetëm ato të paraqitura nga Mbrojtja. Paneli [i Gjykatës së Apelit] arrin në këtë përfundim duke pasur parasysh të drejtën themelore për liri të shtruar për diskutim në lidhje me një të dyshuar apo një të akuzuar që ndodhet në paraburgim para gjykimit dhe prezumimin e pafajësisë që zbatohet në këtë pjesë të procesit”.

⁶⁶ Parashtrimet Plotësuese të Kilajt, para. 9; Shtojca 4 e Parashtrimeve Plotësuese të Kilajt.

konsideratë, asaj i është dhënë pak rëndësi duke marrë parasysh vështirësinë për të zbuluar shkeljen e mundshme të kushteve dhe vërtetimin e këtyre shkeljeve sipas standardeve ligjore. Po kështu, nuk ka masa të tjera që mund të zvogëlojnë ndjeshëm mundësinë e kontakteve të drejtpërdrejta apo të tërthorta me dëshmitarë të mundshëm apo me burime të tjera informacioni relevante për këtë çështje.⁶⁷

34. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Vetëm arrin në përfundimin se kushtet për lirimin e z. Kilaj të propozuara më parë nga Mbrojtja e Kilajt dhe/ose çdo kusht i arsyeshëm *shtesë* që mund të vendoset në mënyrë realiste nga Gjykatësi i Vetëm, mbeten të pamjaftueshme për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii).

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

35. Rregulla 56(2) kërkon “që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes”. Po ky standard zbatohet edhe pas hapjes së çështjes dhe gjatë gjithë fazës së gjykimit.⁶⁸ ZPS-ja “ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi është i domosdoshëm dhe se kohëzgjatja e tij

⁶⁷ *Shih për ngjashmëri* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 38; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 33.

⁶⁸ *Shih* [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 46 (“Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se një panel ka detyrimin e përgjithshëm të garantojë që periudha e kaluar në paraburgim të jetë e arsyeshme, në përputhje me nenin 29(2) të Kushtetutës dhe nenin 5(3) të KEDNJ-së”); KSC-BC-2020-06, F03587, Trupi Gjykses II, [Decision on Periodic Review of Detention of Jakup Krasniqi](#) (Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit), 18 nëntor 2025, publik, para. 31-35 (në lidhje me zbatimin e rregullës 56(2) dhe konstatimin se paraburgimi vazhdon të jetë “i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje”); F03539, Prokurorja e Specializuar, [Prosecution Submission Pertaining to Periodic Detention Review of Jakup Krasniqi](#) (Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit), 27 tetor 2025, publik, para. 26 (ku ZPS-ja argumenton se paraburgimi i Jakup Krasniqit “vazhdon të jetë proporcional”).

vazhdon të jetë e arsyeshme”,⁶⁹ dhe se “si pikënisje për çdo shqyrtim të paraburgimit para gjykimit duhet merret prezumimi i pafajësisë”.⁷⁰ Siç ka vënë në dukje Paneli i Gjykatës së Apelit, “sa më gjatë të mbahet një individ në paraburgim para gjykimit, aq më shumë përgjegjësi kanë Dhomat e Specializuara për të arsyetuar vazhdimin e paraburgimit”.⁷¹

36. Përcaktimi i arsyeshmërisë se vazhdimi të paraburgimit “duhet të vlerësohet në bazë të fakteve të secilës çështje dhe sipas veçorive të saj”.⁷² Në veçanti, në jurisprudencën nga çështjet e mëparshme përcaktohet se arsyeshmëria duhet të vlerësohet duke peshuar faktorë të ndryshëm, ndër të cilët: kohëzgjatja e paraburgimit në kohën e rishikimit të tij;⁷³ “lloji i veprës penale si dhe ashpërsia e dënimit”;⁷⁴ “shkalla e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit”;⁷⁵ shpejtësia me të cilën përparon procesi drejt gjykimit (ose aktgjykimit të formës së prerë), nëse kompleksiteti i procesit për ligj

⁶⁹ Shih [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 47.

⁷⁰ Shih [Selimi Appeal Decision](#) (Vendimi mbi Apelin e Selimit), para. 37.

⁷¹ Shih KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Hysni Gucati's Appeal on Matters Related to Arrest and Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim) (“Vendimi mbi Apelin e Gucatit”), 9 dhjetor 2020, publik, para. 73.

⁷² KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 65.

⁷³ Shih [Selimi Appeal Decision](#) (Vendimi mbi Apelin e Selimit), para. 79-81.

⁷⁴ Shih [Gucati Appeal Decision](#) (Vendimi mbi Apelin e Gucatit), para. 72 (“Paneli i Gjykatës së Apelit përfiton nga ky rast për të theksuar se natyra e veprës penale si dhe ashpërsia e dënimit janë faktorë të rëndësishëm për t’u marrë parasysh kur vendoset nëse paraburgimi është i nevojshëm në rrethanat e një çështjeje specifike”).

⁷⁵ Shih [Kilaj Release Decision](#) (Vendimi mbi Lirimin e Kilajt), para. 60. Shih KSC-BC-2020-06, IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit) (“Vendimi i vitit 2021 mbi Apelin e Thaçit”), 27 tetor 2021, publik, para. 49.

kohëzgjatjen e tij;⁷⁶ dhe rishikimi i shpeshtë i paraburgimit, i cili, sipas Rregullores, kryhet çdo dy muaj.⁷⁷

37. ZPS-ja argumenton se mbajtja në paraburgim e z. Kilaj edhe për dy muaj të tjerë që nga rishikimi i fundit i paraburgimit të tij, nuk ndryshon balancën e faktorëve ku u mbështet konstatimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Pestë të Rishikimit të Paraburgimit se paraburgimi i z. Kilaj “vazhdon të jetë proporcional”.⁷⁸ ZPS-ja thekson se z. Kilaj “mund të marrë një dënim me burgim të gjatë” për dy akuzat me të cilat akuzohet. ZPS-ja gjithashtu thekson “avancimin e vazhdueshëm dhe të shpejtë të procesit”, që pasqyrohet në hapa të ndryshëm proceduralë, hetimorë dhe të nxjerrjes së provave.⁷⁹ Sipas ZPS-së, “faktorë të shumtë relevantë çojnë në përfundimin se mbajtja në paraburgim e z. Kilaj vazhdon të jetë e domosdoshme dhe proporcionale”.⁸⁰ Në Parashtrimet Plotësuese të saj, ZPS-ja gjithashtu jep informacion të ri që supozohet se tregon [REDAKTUAR] për cilat ZPS-ja argumenton se kërkojnë shqyrtim të proporcionalitetit dhe e anojnë më tej peshoren në favor të vazhdimit të paraburgimit ose proporcionalitetit të vazhdimit të paraburgimit.⁸¹

38. Z. Kilaj argumenton se “që nga Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit, ka pasur ndryshime me pasoja dhe zhvillime domethënëse”, ndër të cilat përfundimi së shpejti i fazës së paraqitjes së provave në Çështjen 06; mundësia e vazhdueshme për vonesa para fillimit të gjyqimit në këtë çështje; dhe periudha shtesë e paraburgimit, që bën që periudha e gjithsejtë e

⁷⁶ *Shih [Thaçi 2021 Appeal Decision](#)* (Vendimi i vitit 2021 mbi Apelin e Thaçit), para. 52 (“Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi saktë rrethanat e çështjes gjyqësore në tërësi, duke marrë parasysh faktorët e renditur më lart në paragrafin 50 të këtij Vendimi”); *Kilaj Release Decision* (Vendimi mbi Lirimin e Kilajt), para. 60 (“[...] hapat proceduralë dhe hetimorë të ndërmarrë për ecurinë e çështjes që nga vendimi i fundit për paraburgimin”).

⁷⁷ *Shih [Selimi Appeal Decision](#)* (Vendimi mbi Apelin e Selimit), para. 81.

⁷⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9; *Fifth Review Decision* (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 37.

⁷⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9

⁸⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10.

⁸¹ Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së, para. 9.

paraburgimit të tij para gjykimit të arrijë në “rreth 18 muaj e gjysmë”.⁸² Z. Kilaj gjithashtu argumenton se duhet të merret parasysh edhe periudha prej shtatë muajsh e lirimit të përkohshëm të tij, gjatë së cilës atij iu “kufizua rreptësisht” liria.⁸³ Periudha e kaluar në paraburgim, edhe nëse “provat dhe argumentet e Prokurorisë do të merreshin plotësisht për bazë”, aktualisht “tejkalon çfarëdo dënimi me burgim që [z. Kilaj] do të rrezikonte të merrte edhe në rast të shpalljes fajtor” për të dyja veprat penale për të cilat akuzohet.⁸⁴ Z. Kilaj parashtrohet se këta faktorë favorizojnë konstatimin se “mbajtja në paraburgim nuk është më as e arsyeshme, as proporcionale”.⁸⁵

39. Gjykatësi i Vetëm konstaton se, megjithëse faktorët që lidhen me paraburgimin kanë peshë të përafërt, dhe pavarësisht nga niveli i rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) dhe të evidentuara në pjesën pararendëse, ZPS-ja nuk e ka përmbushur detyrimin e vet për të treguar se vazhdimi i paraburgimit të z. Kilaj vijon të jetë i arsyeshëm. Përkundrazi, kohëzgjatja e paraburgimit, duke pasur parasysh faktet konkrete në rastin e z. Kilaj, aktualisht ka arritur pikën e të qenit e paarsyeshme.

40. Së pari, deri në datën e këtij vendimi, z. Kilaj ka qenë në paraburgim të DHS-së për gjithsej 18 muaj e dhjetë ditë. Sipas nenit 401(5) të Kodit Penal të Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (“KPK”), shkallëzimi i dënimit për më të rëndën prej dy veprave penale për të cilat ai akuzohet, është nga një deri në pesë vjet burgim.⁸⁶

41. Gjykatësi i Vetëm vëren se “ai nuk ka detyrimin të trajtojë dënimin e ‘mundshëm’ që mund të marrë një i akuzuar, pasi aspektet në lidhje me faktorët

⁸² Përgjigjja e Kilajt, para. 2-5.

⁸³ Përgjigjja e Kilajt, para. 19.

⁸⁴ Përgjigjja e Kilajt, para. 21-24.

⁸⁵ Përgjigjja e Kilajt, para. 25.

⁸⁶ Sipas rregullës 163(4), “dënimi i njësuar [që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit], nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë”.

e mundshëm në rast të një verdikti fajësie dhe dënimi, nuk duhet të jenë pjesë e vendimit mbi lirimin e përkohshëm” dhe se “vlerësimi i proporcionalitetit duhet të bazohet vetëm në rrethanat në kohën e rishikimit”.⁸⁷ Nuk ka nevojë për një hamendësim të tillë për të vërejtur se periudha e paraburgimit para gjykimit e z. Kilaj, aktualisht tejkalon ndjeshëm – me më shumë se gjashtë muaj – dënimin më të ulët të përcaktuar nga ligjvënësi për akuzën penale më të rëndë me të cilën ai përballlet. Gjykatësi i Vetëm nuk do të spekulojë, edhe bazuar në një vlerësim që “merr plotësisht për bazë provat dhe argumentet e ZPS-së”, nëse periudha e paraburgimit e z. Kilaj aktualisht tejkalon cilindo dënim “të mundshëm”, në rast të një verdikti fajësie ndaj tij. Sidoqoftë, fakti që periudha e paraburgimit aktualisht tejkalon ndjeshëm dënimin më të ulët, është faktor që favorizon lirimin e përkohshëm.

42. Së dyti, periudha e kaluar në paraburgim deri më sot, ndikon edhe në nivelin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), në veçanti të rrezikut të pengimit të procesit. Motivi që qëndron në themel të këtyre rreziqeve, zvogëlohet në përpjestim me çdo dënim të mundshëm, i cili nga ana e vet zvogëlohet me çdo ditë të kaluar në paraburgim. Edhe pse dënimi i mundshëm i pavuajtur për akuzën më të rëndë është prapëseprapë ai me deri në tre vjet e gjysmë burgim, ky dënim aktualisht ka një vit të plotë më pak sesa kur z. Kilaj u lirua përkohësisht në maj 2024, kohë në të cilën ai ishte tashmë në dijeni se mund të përballej me akuza sipas nenit 401(2) të KPK-së.⁸⁸

43. Së treti, dhe në lidhje me këtë, ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë se z. Kilaj ka tentuar të pengojë procesin kundër tij (ose të arratiset, për atë punë) gjatë periudhës prej 204 ditësh të lirimit të përkohshëm të tij, midis majit dhe

⁸⁷ [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 49.

⁸⁸ *Shih më lart* para. 21.

dhjetorit 2024.⁸⁹ Edhe pse në atë kohë këto rreziqe u vlerësuan si “serioze”,⁹⁰ nuk ka prova se ato u manifestuan në ndonjë mënyrë. Ndonëse kjo nuk përjashton mundësinë që këto përpjekje të jenë bërë pa u zbuluar, veçanërisht në lidhje me pengimin e procesit, mungesa e treguesve të tillë është faktor që “tregon drejtpërdrejt se çfarë rreziqesh mund të shkaktohen” nga një periudhë e dytë lirimi.⁹¹ Realisht, mungesa e treguesve të tillë është veçanërisht relevante duke pasur parasysh se koha sa mund të zgjaste mbajtja në burg pas shpalljes së fajësisë ishte shumë më e gjatë dhe motivi i lidhur me të për të penguar shumë më i fortë, në maj 2024, se sa është tani.

44. Së katërti, faza e paraqitjes së provave në Çështjen 06, përfshirë paraqitjen e provave të Mbrojtjes, tani kryesisht ka përfunduar.⁹² Bashkë me periudhën e mëtejshme të paraburgimit të z. Kilaj, kjo përbën një ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që nga vendimi i fundit i rishikimit të paraburgimit. Në fakt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake u mbështet shprehimisht në vazhdimin e procesit gjyqësor në Çështjen 06, si faktor rreziku që favorizon vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj.⁹³ Ndonëse ekziston rreziku që ndaj dëshmitarëve që

⁸⁹ [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 34 (“Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Kilaj u mbajt në paraburgim nga 2 nëntori 2023 deri më 15 maj 2024, dhe sërish që nga arrestimi i tij më 5 dhjetor 2024”).

⁹⁰ [SPO Appeal Decision](#) (Vendimi mbi Apelin e ZPS-së), para. 22.

⁹¹ [Bemba et al. Decision on Interim Release](#), para. 19-20 (“Prokuroria nuk paraqet asnjë provë, përveç thjesht hamendësimeve, se dikush prej katër të akuzuarve ka bërë diçka gjatë kohës së lirit, që lë të kuptohet se ekziston rreziku që ata të arratisen, të pengojnë hetimet ose të vazhdojnë të kryejnë krime të tjera [...]. Sjellja e të paraburgosurve në pritje të gjykimit është faktor relevant kur shqyrtohet lirimi me kusht, ndonëse pesha që i duhet dhënë këtij faktori duhet të vlerësohet rast pas rasti. Në këtë çështje, Dhoma gjykon se këtij faktori duhet t’i jepet peshë e konsiderueshme sepse sjellja para gjykimit e të katër të akuzuarve gjatë kohës së lirit të tyre, është tregues i drejtpërdrejtë se çfarë rreziqesh mund të shkaktohen nëse vazhdohet me lënien në liri të tyre.”).

⁹² *Shih më lart* para. 26.

⁹³ [Fifth Review Decision](#) (Vendimi i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 24 (“Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se rreziku i pengimit nuk ka pushuar së ekzistuari me përfundimin e paraqitjes së provave dhe argumenteve të ZPS-së në [gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*], pasi procesi po vazhdon.”); [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit), para. 31 (“procesi në Çështjen 06 po vazhdon dhe Trupi Gjykes mund të dëgjojë dëshmi nga viktima pjesëmarrëse, dëshmitarë të mbrojtjes dhe dëshmitarë që paraqesin kundërprova, përfshirë nga dëshmitarë që tashmë kanë dëshmuar”).

kanë dëshmuar më parë në Çështjen 06 të ushtrohet ndikim që ata t'i tërheqin dëshmitë e tyre,⁹⁴ kjo mundësi është ndjeshëm më e ulët sesa rreziku i ndikimit te dëshmitarët që ende nuk kanë dëshmuar.

45. Së pesti, ndonëse vazhdon të ekzistojë rreziku i ndikimit te dëshmitarët që ende nuk kanë dëshmuar në Çështjen 12, mundësia për ta bërë këtë duhet vlerësuar si jashtëzakonisht e ulët në lidhje me provat e ZPS-së, të cilat mbështeten në prova dokumentare dhe në dëshmitarë, ndaj të cilëve nuk është e besueshme se z. Kilaj mund të ndërhyjë ose të ndikojë.⁹⁵ Gjykatësi i Vetëm mban parasysh konstatimet e veta të mëhershme në lidhje me rrezikun e pengimit nga z. Kilaj, të cilat aktualisht mund të përforcohen nga informacioni shtesë i paraqitur në Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së,⁹⁶ dhe se ky rrezik ka shumë të ngjarë të manifestohet në lidhje me dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes në Çështjen 12, veçanërisht duke pasur parasysh atmosferën e ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve në Kosovë, që është pranuar në jurisprudencën e mëparshme.⁹⁷ Gjykatësi i Vetëm hedh poshtë argumentin e ZPS-së se nuk duhet të urdhërohet lirimi i përkohshëm deri sa të merren rezultatet e hetimeve që po kryhen [REDAKTUAR].⁹⁸ Mundësia që në të ardhmen të zbulohet informacion i ri është shumë e vogël dhe spekulative, veçanërisht krahasuar me veprimet për të cilat janë ngritur akuzat, baza faktike e të cilave është më e vërtetuar si bazë për vlerësimin e rrezikut të përcaktuar në nënparagrafin (ii) të nenit 41(6)(b).

⁹⁴ *Shih më lart* para. 26.

⁹⁵ *Shih më lart* para. 26.

⁹⁶ Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së, para. 4-10.

⁹⁷ [Second Kilaj Detention Appeal Decision](#) (Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Kilajt), para. 83 ("për Gjykatësen e Procedurës Paraprake ishte e arsyeshme që, si faktor kontekstual, të mbante parasysh atmosferën e ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë, gjatë vlerësimit prej saj të rrezikut të pengimit prej Kilajt të procesit të Dhomave të Specializuara").

⁹⁸ Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së, para. 8.

46. Së gjashti, ZPS-ja aktualisht ka konfirmuar se i ka përfunduar në thelb hetimet e veta në këtë çështje.⁹⁹ Ato fusha të vetme të hetimit që kanë mbetur, janë përtej mundësisë së z. Kilaj për të ndikuar.

47. Gjykatësi i Vetëm është i vetëdijshëm dhe mban parasysh konstatimet e veta në lidhje me ekzistencën e rreziqeve të përcaktuara në nënparagrafët (ii) dhe (iii) të nenit 41(6)(b) në lidhje me z. Kilaj.¹⁰⁰ Megjithatë, ky konstatim nuk është në mospërputhje me konstatimin se periudha e paraburgimit para gjykimit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë, është bërë e paarsyeshme dhe joproporcionale. Siç ka pranuar Paneli i Gjykatës së Apelit, në një rast të veçantë edhe ekzistenca e “rreziqeve serioze” mund të mos peshojë më shumë se “e drejta themelore për liri” e një të akuzuari.¹⁰¹ Në këtë çështje, niveli i rrezikut është ndjeshëm më i ulët se “serioz”, dhe nuk peshon më shumë se faktorët e tjerë, ndër të cilët: (i) periudha e paraburgimit, që tani është brenda shkallëzimit të dënimit të përcaktuar në ligj, edhe sikur z. Kilaj të shpallet fajtor për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet; (ii) mbyllja së afërmi e dëgjimit të provave në Çështjen 06; (iii) lloji i provave dhe argumenteve që ZPS-ja do të paraqesë në Çështjen 12; dhe (iv) periudha e mëhershme e lirimit të përkohshëm. Në këto rrethana, ndërhyrja në të drejtën themelore për liri të z. Kilaj, nuk peshon më pak se ekzistenca e rreziqeve të përcaktuara në nënparagrafët (ii) dhe (iii) të nenit 41(6)(b). Duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur dhe marrë në konsideratë si duhet prezumimin e pafajësisë së z. Kilaj, vazhdimi i paraburgimit të z. Kilaj në bazë të rregullës 56(2), në këto rrethana do të ishte i paarsyeshëm.

⁹⁹ KSC-BC-2023-12, F00559, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00549*, 20 nëntor 2025, konfidenciale, para. 7; version i redaktuar publik u dorëzua më 26 nëntor 2025, F00559/RED.

¹⁰⁰ *Shih më lart* para. 27, 29-30.

¹⁰¹ [SPO Appeal Decision](#) (Vendimi mbi Apelin e ZPS-së), para. 22 (“Edhe pse këto rreziqe serioze ende ekzistojnë, Gjykatësi i Vetëm arriti në përfundimin se ato nuk peshojnë më shumë se e drejta themelore për liri e z. Kilaj”); [Kilaj Release Decision](#) (Vendimi mbi Lirimin e Kilajt), para. 63 (“ekzistenca e këtyre rreziqeve nuk peshon më shumë se e drejta themelore për liri e z. Kilaj”).

F. KUSHTET E LIRIMIT

48. Siç u shtjellua më lart, Gjykatësi i Vetëm gjykon se kushtet e lirimit të vendosura në maj 2024, janë kornizë e provuar dhe e duhur për lirim të përkohshëm. ZPS-ja ka sugjeruar [REDAKTUAR].¹⁰²

49. Gjykatësi i Vetëm vëren se këto masa konkrete tejkalojnë dukshëm atë çfarë u kërkua gjatë periudhës së mëhershme të lirimit me kusht të z. Kilaj. Dy kufizimet e fundit do të ndalonin një gamë të gjerë kontaktesh të pafajshme.

50. Gjykatësi i Vetëm vendos të urdhërojë kushtet e mëposhtme për lirimin e z. Kilaj:

- (a) Z. Kilaj nuk duhet të largohet nga territori i Kosovës, përveçse me leje të një paneli kompetent të DHS-së;
- (b) Z. Kilaj duhet t'i dorëzojë Administratores pasaportën e tij dhe çdo dokument tjetër udhëtimi, përfshirë viza dhe dokumente të tjera identiteti që mund të përdoren për të udhëtuar – këtu përfshihet çdo pasaportë e re apo dokument udhëtimi i ri i lëshuar nga autoritetet e Kosovës, apo ndonjë autoritet tjetër pas lëshimit të këtij vendimi; në qoftë se do të kërkohet prania e z. Kilaj në selinë e DHS-së, Zyra Administrative do t'ia japë atij pasaportën vetëm për këtë qëllim; pasaporta duhet të dorëzohet pas kthimit të tij në Kosovë;
- (c) Z. Kilaj duhet të japë adresën në të cilën do të banojë gjatë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor dhe të kërkojë leje nga DHS-ja para çdo ndryshimi të vendbanimit;
- (d) Si kusht paraprak për lirimin e tij, z. Kilaj duhet t'ia japë Administratores një garanci financiare përmes transferimit të shumës prej 40.000 eurosh [REDAKTUAR];

¹⁰² Parashtrimet Plotësuese të ZPS-së, para. 12.

- (e) Z. Kilaj nuk duhet të ketë asnjëfarë kontakti apo komunikimi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përmes personave të tjerë), të çfarëdolloj mënyre me personat e tjerë të akuzuar bashkë me të (Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi), ose me cilindo person që ai ka dijeni se është vizitor i ndonjërit prej personave të tjerë të akuzuar bashkë me të në objektin e paraburgimit të DHS-së;
- (f) Z. Kilaj nuk duhet të ketë asnjëfarë kontakti apo komunikimi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përmes personave të tjerë),¹⁰³ të çfarëdolloj mënyre me asnjë person që ai ka dijeni se është dëshmitar në këtë çështje ose në çështje të tjera gjyqësore para Dhomave të Specializuara;
- (g) Z. Kilaj nuk duhet të ketë asnjë kontakt apo komunikim, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përmes personave të tjerë), me asnjë person për të cilin janë ngritur pretendime në Aktakuzën e Konfirmuar se ka marrë pjesë në veprimet penguese ose ka dhënë ndihmë në kryerjen e tyre në këtë çështje, [REDAKTUAR];
- (h) Z. Kilaj nuk duhet të diskutojë me askënd, përveçse me anëtarët e caktuar të ekipit të tij të Mbrojtjes, detaje të përmbajtjes së çështjes së tij, qofshin ato publike apo konfidenciale, përfshirë me anëtarë të familjes së ngushtë, dhe të njoftojë këdo që bën pyetje në lidhje me çështjen e tij se dhënien e këtij lloj informacioni e ka të ndaluar nga DHS-ja;
- (i) Z. Kilaj nuk duhet të bëjë, drejtpërdrejt ose tërthorazi (për shembull përmes anëtarëve të familjes), deklarata publike në media dhe/ose në mediat sociale lidhur me DHS-në, ZPS-në dhe/ose proceset në DHS;

¹⁰³ Është e qartë se kontaktet e ligjshme përmes mbrojtësit në përputhje me urdhrat në fuqi dhe dispozitat statutorë të DHS-së, nuk përfshihen në këtë ndalim.

- (j) Z. Kilaj duhet të paraqitet çdo javë në policinë e Kosovës për kontroll verifikues, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Administratorja;
- (k) Z. Kilaj duhet të paraqitet për t'u dorëzuar në paraburgim të DHS-së, në qoftë se urdhërohet ta bëjë këtë, dhe duhet të marrë pjesë në çdo seancë gjyqësore kur i kërkohet nga DHS-ja; çdo mosparaqitje në DHS kur urdhërohet ta bëjë këtë, do të çojë në moskthimin e garancisë financiare të përcaktuar në nënparagrafin (d) dhe në lëshimin e menjëhershëm të fletarrestimit për të;
- (l) Në lidhje me praninë e tij në seancat gjyqësore, Z. Kilaj duhet të informojë Administratoren për adresën ku do të banojë gjatë kohës që do të jetë në territorin e shtetit pritës dhe duhet të respektojë të gjitha kufizimet që mund t'i vendosen nga shteti pritës në lidhje me lëvizjet e tij në territorin e atij shteti gjatë periudhës së qëndrimit të tij atje;
- (m) Z. Kilaj duhet të respektojë klasifikimin e këtij vendimi dhe nuk duhet të publikojë, nxjerrë ose diskutojë përmbajtjen e tij, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me asnjë person, as me akuzuarit në objektin e paraburgimit dhe familjarët e tij, përveçse me mbrojtësin e tij, deri kur ky vendim të bëhet publik me urdhër të Gjykatësit të Vetëm; dhe
- (n) Z. Kilaj duhet të përmbushë çdo vendim, urdhër apo udhëzim tjetër të Gjykatësit të Vetëm dhe Administratores.

51. Gjykatësi i Vetëm thekson se, në qoftë se shkelet ndonjë prej kushteve të lartpërmendura, do të lëshohet menjëherë fletarrestim për z. Kilaj.

52. Z. Kilaj dhe ekipi i tij i Mbrojtjes urdhërohen që të mos ia tregojnë përmbajtjen e këtij vendimi, që vazhdon të jetë konfidencial, asnjë personi tjetër, as të akuzuarve të tjerë në objektin e paraburgimit të DHS-së, as anëtarëve të

familjes, derisa të jenë zbatuar të gjitha masat paraprake dhe të jetë realizuar lirimi i sigurt i z. Kilaj në Kosovë. [REDAKTUAR].

V. KLASIFIKIMI

53. Për arsye sigurie, ky vendim klasifikohet përkohësisht si konfidencial. Në rast se vendoset të bëhet publik dhe kur ky proces të përfundojë, do të dorëzohet versioni i redaktuar publik i këtij vendimi.

VI. VENDIM

54. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a. **MIRATON** kërkesën e z. Kilaj për zgjatjen e afatit të dorëzimit të Përgjigjes së Kilajt;
- b. **URDHËRON** lirimin e z. Kilaj nga paraburgimi në përputhje me Marrëveshjen me Shtetin Pritës, sipas kushteve të rrepta të përcaktuara në paragrafin 50 të këtij vendimi, deri në zbatimin e të gjitha masave të nevojshme praktike nga Administratorja;
- c. **URDHËRON** Administratoren të [REDAKTUAR] dhe të marrë të gjitha masat e tjera të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi;
- d. **PËRCAKTON** se lirimi i z. Kilaj, sikurse urdhërohet në nënparagrafin (b) më lart, do të hyjë në fuqi sapo të jetë kryer pagesa e plotë e garancisë financiare për lirimin e tij, në përputhje me paragrafin 50(d) të këtij vendimi, dhe **VENDOS** zgjatjen e paraburgimit të z. Kilaj deri në atë kohë;
- e. **URDHËRON** Administratoren të dokumentojë kohën e transferimit të garancisë financiare për z. Kilaj [REDAKTUAR];
- f. **URDHËRON** Administratoren të marrë sa më shpejt që të jetë e mundur të gjitha masat praktike, dhe **AUTORIZON** Administratoren të mbajë kontakte me autoritetet kompetente të shtetit pritës dhe çdo autoritet tjetër kompetent, sipas nevojës; dhe
- g. **URDHËRON** z. Kilaj dhe ekipin e tij të Mbrojtjes që përmbajtjen e këtij vendimi, i cili është konfidencial, të mos ia bëjnë të ditur asnjë personi tjetër, as të akuzuarve të tjerë në objektin e paraburgimit të DHS-së. si dhe anëtarëve të familjes, derisa të zbatohen të gjitha masat praktike dhe të realizohet lirimi i sigurt i z. Kilaj në Kosovë, sikurse

përcaktohet në paragrafin 52 të këtij vendimi

/nënshkrimi/

Gjykatës Kristofer Gosnell

Gjykatës i Vetëm

E mërkurë, 3 dhjetor 2025

Në Hagë, Holandë.